Prioritetet e Departamenteve të Gjykatës dhe Rekomandimet për Vitin 2025

Departamenti Special

Prioritetet:

1. Përmbushja e planit te veçanta të punës, në të cilin do të prioritizohen lëndët të cilat do të përfundojnë brenda vitit 2025 (detajet tjera planit i bashkangjitur);
2. Caktimi i seancave në bllok dhe zvogëlimin e numrit të seancave të shtyra dhe të anuluar.
3. Ngritja e cilësisë së vendimmarrjes respektivisht zvogëlimi i numrit të lëndëve të kthyer në rigjykim;
4. Zbatimi në tërësi i sistemit SMIL gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore;
5. Zbatimi i Planit Strategjik për Prioritizimin e lëndëve dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025;
6. Zbatimi i planit strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit;
7. Zbatimi i programit për audio dhe video incizim të seancave në sallat e gjyqimit;
8. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara;
9. Aplikimi i Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore;

Departamenti për Krime të Rënda (DKR)

Prioritetet:

1. Caktimi i seancave në bllok dhe zvogëlimin e numrit të seancave të shtyra dhe të anuluar.
2. Ngritja e cilësisë së vendimmarrjes respektivisht zvogëlimi i numrit të lëndëve të kthyer në rigjykim;
3. Zbatimi në tërësi i sistemit SMIL gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore;
4. Zbatimi i Planit Strategjik për Prioritizimin e lëndëve dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025;
5. Zbatimi i planit strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit;
6. Zbatimi i programit për audio dhe video incizim të seancave në sallat e gjyqimit;
7. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara;
8. Aplikimi i Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore;

Departamenti për të Mitur (DM)

Prioritetet e DM-së

1. Zbatimi i Planit Strategjik për Prioritizimin e lëndëve dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025.
2. Zbatimi i seancave bllok
3. Sigurimi i një mjedisi miqësor dhe jo traumatizues gjatë gjyqimit
4. Zbatimi në tërësi i sistemit SMIL gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore
5. Zbatimi i programit për audio dhe video incizim të seancave në sallat e gjyqimit

Departamenti Përgjithshëm/Divizioni Penal (DP)

Prioritetet:

1. Caktimi i seancave në bllok dhe zvogëlimin e numrit të seancave të shtyra dhe të anuluar.
2. Ngritja e cilësisë së vendimmarrjes respektivisht zvogëlimi i numrit të lëndëve të kthyer në rigjykim;

3. Zbatimi në tërësi i sistemit SMIL gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore;
4. Zbatimi i Planit Strategjik për Prioritizimin e lëndëve dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025;
5. Zbatimi i planit strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit;
6. Zbatimi i programit për audio dhe video incizim të seancave në sallat e gjyqësorisë;
7. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara;
8. Aplikimi i Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore;

Divizioni Civil (DC)

Prioritetet:

1. Zbatimi i Planit Strategjik për Prioritizimin e lëndëve dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025, trajtimi me kohë i lëndëve që ligji iu jep prioritet, lëndëve të vjetra dhe lëndëve të kthyera në rigjykim.
2. Ngritja e cilësisë së vendimmarrjes respektivisht zvogëlimi i numrit të lëndëve të kthyera në rigjykim;
3. Reduktimi i lëndëve të vjetra
4. Zbatimi në tërësi i sistemit SMIL gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore;
5. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara;
6. Planifikimi i seancave dhe zvogëlimi i numrit të seancave të shtyera dhe të anuluar;
7. Zbatimi i planit të veçantë për trajtimin e lëndëve që lindin nga kontrata kolektive.

Divizioni për Kundërvajtje

Prioritetet:

1. Zgjidhja e një numri më të madh të lëndëve, duke parandaluar parashkrimin e lëndëve;
2. Zvogëlimi i numrit të lëndëve të pazgjidhura përmes optimizimit të procedurave;
3. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara;
4. Planifikimi i seancave dhe zvogëlimi i numrit të seancave të shtyera dhe të anuluar;
5. Përdorimi në tërësi i sistemit SMIL

Departamenti Administrativ

Prioritetet:

1. Zbatimi i Planit Strategjik për Prioritizimin e lëndëve dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025, trajtimi me kohë i lëndëve që ligji iu jep prioritet, lëndëve të vjetra dhe lëndëve të kthyera në rigjykim.
2. Ngritja e cilësisë së vendimmarrjes respektivisht zvogëlimi i numrit të lëndëve të kthyera në rigjykim;
3. Reduktimi i lëndëve të vjetra
4. Zbatimi në tërësi i sistemit SMIL gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore;
5. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara;

6. Planifikimi i seancave dhe zvogëlimi i numrit të seancave të shtyera dhe të anuluar;

Përcaktimi i objektivave dhe përgjegjësi të të punësuarve brenda administratës së gjykatës për të siguruar efikasitet në punë

Të gjithë punonjësit si më lartë do kujdesen që pa vonesë dhe me përgjegjësi ti kryejnë detyrat e veta duke u kujdesur që gjatë pranimit lëndët duhet të regjistrohen në SMIL në përputhje me Rregullorën për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave, Rregulloren për Përdorimin e sistemit SMIL dhe me Protokolin e lëvizjes së lëndëve.

Kujdes i veçantë do ti kushtohet veprimeve që sigurojnë se lënda fizike dhe ajo elektronike duhet të kenë përmbajtjen e njëjtë e cila realizohet duke pranuar, skanuar dhe regjistruar në SMIL secilin dokument apo shkresë të pranuar.

Duke filluar nga Janari i vitit 2025 e tutje vendimet me të cilat përfundohet procedura gjyqësore, në të gjitha departamentet në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës do të ekspedohen nga zyrtarët ligjor të gjyqtarëve të caktuar por fletë kthesat si dëshmi e ekspeditimit të vendimeve do të pranohen nga referenti përkatës i gjyqtarit të caktuar sipas tabelës më lartë.

Procedura e dërgimit të lëndëve në gjykatat e instancave më të larta sipas mjeteve të goditjes duhet të jetë ekspeditive, praktikisht secila ankesë e pranuar duhet menjëherë të hyj në punë dhe të procedohet pa shkaktuar asnjë vonesë.

Dërgimi i lëndëve në shkallët më të larta sipas mjetit të ankimimit do të kryhet nga vetë referentët që kanë përgatitur lëndën, kjo për dallim nga vitet paraprake kur ankesat fizikisht janë dërguar nga zyra e fletë dorëzuesve.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Zyra e ekzekutimeve penale

Ekzekutimet e Vendimeve gjyqësore në lëmine penale gjatë vitit 2025 do të kryhen nga katër (4) referent, në përbërje prej Ganimete Krasniqi⁵, Arianit Mahmutaj, Blerta Rashiti dhe Fahrije Beha⁶.

Kjo zyrë edhe pse ka arrit një stabilitet të mirë gjykata në fokus ka përmirësimin edhe më tutje të shërbimeve të vitin 2025 pas shtimit të numrit të zyrtarëve të angazhuar në këtë zyrë.

Synim i gjykatës është që të arrihet që në vitin 2025 secila lëndë sapo të pranohet në zyrë menjëherë të fillohet procedura e ekzekutimit duke u ndërmarrë të gjitha veprimet që janë në funksion të ekzekutimit të atij vendimi.

Zyra e ekzekutimit të vendimeve civile

Kjo zyrë përbëhet aktualisht nga gjashtë referent si në vijim: Florim Hasani, Naim Rrustemi, Enver Alushani, Besim Spahiu, Fatmir Ramadani dhe Baki Rrahmani.

⁵ Ganimete Krasniqi me pozitë është sekretare juridike por ushtron pozitën e referentes.

⁶ Fahrije Beha me pozitë është sekretare juridike por ushtron pozitën e referentes.

Z. Florim Hasani mban pozitën e UD udhëheqësit të Zyrës së Menaxhimit të Lëndëve ndërsa Z. Naim Rrustemi gjithashtu me vendim të SKGJK krahas pozitës referent ushtron edhe detyrën e Mbikëqyrësit të Sektorit për Ekzekutim dhe Arkivim.

Referentët Fatmir Ramadani dhe Baki Rrahmani janë me masë suspendimi.

Zyra e ekzekutimit të vendimeve të kundërvajtjes

Janë të caktuara tre (3) referente të cilat do të veprojnë në funksion të ekzekutimit të të gjitha vendimeve që janë të plotfuqishme në lëminë e kundërvajtjes.

Ekzekutimi i vendimeve të kundërvajtjes kryhet nga tri (3) referente, ato janë Elhame Krasniqi, Advije Zena dhe Bahrije Krasniqi⁷, të cilat do jenë përgjegjëse për zbatimin e të gjitha procedurave ligjore që mundësojnë shkallë të lartë të ekzekutimit të vendimeve në lëminë e kundërvajtjes.

Respektimi i afateve për dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë, si dhe ekzekutimi me kohë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke përfshirë edhe vendimeve gjyqësore nga lëmia e kundërvajtjes.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, ku është shtuar numri i referentëve në këto dy segmente me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe eliminimit të sfidave të paraqitura, pritet që gjatë vitit 2025 të respektohet afati për dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së dytë, si dhe ekzekutimi me kohë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Referentët në këto dy lëmi do të monitorohen në baza mujore nga ana e Administratorit të Gjykatës, i cili do të raportojë për ecurinë të Kryetarja e Gjykatës.

Përcaktimi i kalendarit vjetor të mbledhjeve të kolegjiut të gjyqtarëve të gjykatës, gjyqtarëve të degës dhe bashkëpunëtorëve

Kryetarja e gjykatës do të mbajë takime të rregullta me gjyqtarët mbikëqyrës, gjyqtarët, administratorin e gjykatës dhe ndihmës administratorët e gjykatës për të diskutuar menaxhimin dhe koordinimin e punëve të gjykatës themelore dhe degëve të saj, varësisht nevojës së paraqitur dhe kërkesave lidhur me menaxhimin, organizimin dhe funksionimin e gjykatës.

Në bazë të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave të Republikës së Kosovës X/2024, një herë në 3(tre) muaj por jo ditën e fundit të punës së muajit të tretë do të mbahen kolegjiutet me gjyqtarët e gjykatës për të diskutuar në lidhje me administrimin e gjykatës, për të shqyrtuar organizimin e punës, rezultatet e arritura në gjykatë dhe për t'i trajtuar problemet dhe sfidat e punës.

Nënkryetarja e Gjykatës dhe Administratori i Gjykatës do të mbajnë takime të rregullta edhe me bashkëpunëtorët dhe stafin administrativ, sipas nevojës së paraqitur dhe kërkesave nga të njëjtët për adresim të problemeve a po sfidave.

⁷ Bahrije Krasniqi me pozitë është sekretare juridike por ushtron pozitën e referentes.

Zbatimi i Programit SMIL për Regjistrimin e lëndëve, caktimin e seancave, vendosjen e akteve procedurale si dhe akteve finale, duke siguruar kualitet të të dhënave, respektivisht përputhje të plotë të dosjes fizike me dosjen elektronike, evitimi i shtyrjes dhe anulimit të seancave të planifikuara dhe hartimi i raporteve për numrin e seancave të mbajtura, seancave të shtyera dhe seancave të anuluar.

Në vazhdimësi nga gjyqtarët është kërkuar dhe do të kërkohej përdorimi i sistemit SMIL, me ç rast gjatë vitit 2025 është vendosur monitorimi i disa segmenteve të përdorimit të sistemit SMIL nga ana e gjyqtarëve, për çka do të angazhohet zyrtarja për statistika me asistimin e zv. Administratores së Gjykatës që në baza mujore të nxjerrë numrin e seancave të caktuara nga ana e gjyqtarëve, nëse të njëjtat janë të caktuara përmes sistemit SMIL, nëse seancat janë shtyrë a po anuluar përmes sistemit SMIL, si dhe nëse është përcaktuar arsyeja e shtyrjes a po anulimit. Në bazë të raporteve, Kryetarja e Gjykatës do të raportoj për secilin gjyqtarë në veçanti për përdorimin e sistemit SMIL. Sipas përcaktimit të punëve më lartë, referentët dhe zyrtarët ligjor do të monitorohen nga ana e Administratorit dhe zv. Administratores së Gjykatës, për përdorimin e sistemit SMIL.

Zbatimi i Evidencës Penale, duke siguruar vendosje të drejtë dhe brenda afateve, në pajtim të plotë me aktin gjyqësor

Gjatë vitit 2025 do të zbatohet në tërësi Rregullorja nr. X/2024 Për Evidencën Penale në Republikën e Kosovës. Në zyrën e evidencës penale brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë janë caktuar dy referentë, të cilët janë liruar nga të gjitha detyrat e tjera dhe detyra e tyre ekskluzivisht do të jetë vendosja e drejtë, pa gabime dhe brenda afateve të vendimeve në SQEP. Krahas dënimeve kryesore, është paraparë se në sistemin e evidencës penale të vendosen edhe dënimet plotësuese të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe dënimet sipas plotësim Kodit të ri penal. Në baza ditore referentët do të monitorohen për punën e tyre.

Kalendari i mbajtjes së seancave efektive(bllok) për të trajtuar lëndët me efikasitet

Gjatë vitit 2025 do të zbatohet në tërësi caktimi i seancave bllok në Departamentin Special dhe Departamentin për Krime të Rënda. Kryetarja e Gjykatës përmes mbikëqyrësve të departamenteve do të mbikëqyr zbatimin e caktimit.

Zbatimi i programit për audio dhe video incizim të seancave në sallat e gjykimit në fushën penale

Në tërësi do të zbatohet Rregullorja për zbatimin e programit audio dhe video-incizim të seancave në sallat e gjykimit. Monitorimi i zbatimit të kësaj rregullore do të bëhet nga ana e Mbikëqyrësve të Departamenteve të cilët do të kenë obligim që në baza mujore të raportojnë te Kryetarja e Gjykatës në lidhje me përdorimin e këtyre pajisjeve nga ana e gjyqtarëve.

Shfrytëzimi i sallave të gjykimit në rastet penale

Gjyqtarët janë të obliguar që të shfrytëzojnë sallat e gjykimit dhe seancat gjyqësore të mbahen në sallat e gjykimit, përveç në raste të tjera specifike me arsyetim paraprak të Kryetarja e Gjykatës.

Publikimi i akteve gjyqësore meritore, e të cilat nuk kanë kufizime për publikim

Gjyqtarët së bashku me stafin e zyrës do të mbahen përgjegjës për publikim të vendimeve gjyqësore dhe nga të njëjtit do të kërkohet në baza mujore raportim në lidhje me publikimin e vendimeve në ëeb-portalën e Gjykatës.

Zbatimi i planit të trajnimeve nga bashkëpunëtorët dhe administrata

Gjykata Themelore në Prishtinë dhe degë është në rrugë të mirë në përfundimin e trajnimeve në modulën penal dhe civil për bashkëpunëtorët profesional, bazuar në Rregulloren e KGJK-së për trajnimin e të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor, ku gjatë vitit 2025 pritet të përfundohen trajnimet nga këto dy module për të gjithë bashkëpunëtorët. Ndërsa, po ashtu është duke u punuar edhe në mbajtjen e trajnimit për zyrtarët dhe referentët, ku gjatë vitit 2025 synohet që këto trajnime të përfundohen nga të gjithë stafi, varësisht edhe numrit të trajnimeve të organizuara nga Akademia e Drejtësisë. Kryetarja e Gjykatës dhe Administratori do të jenë në përcjellje dhe në komunikim të vazhdueshëm me Akademinë e Drejtësisë.

Vlerësimi i performancës së punës për bashkëpunëtorët dhe zyrtarët e administratës

Në periudhën 01-31 Janar 2025 Kryetarja e Gjykatës do të kërkojë nga Administratori i Gjykatës dhe gjyqtarët formularët për vlerësimin e performancës së bashkëpunëtorëve për vitin 2024 bazuar në Rregulloren për statusin dhe të drejtat e bashkëpunëtorit profesional. Origjinali i formularit do të i dorëzohet bashkëpunëtorit profesional ndërsa një kopje do të dorëzohet te Zyra e Personelit.

Po ashtu, në bazë të raporteve mujore, Kryetarja e Gjykatës do të bëjë në vazhdimësi vlerësime për punën e bashkëpunëtorëve, ku të gjeturat do të diskutojë në kolegjiunet e përbashkëta dhe po ashtu në raportet 3(tre) mujore do të raportojë për arritjen e normës për bashkëpunëtorët.

Gjatë vitit 2025, mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë do të bëjnë vlerësimin e performancës për nëpunësit sipas Rregullosës Nr. 10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në punë për nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, vlerësimi i cili do të përfshijë planifikimin dhe organizimin, iniciativën dhe kreativitetin, komunikim dhe përfaqësimin, efektivitetin në punë, respektimin të orarit të punës etj. Vlerësimi do të bëhet për periudhën 1 vjeçare dhe do të kryhet deri në ditën e fundit të muajit Shkurt 2026.

Varësisht vlerësimit të performancës, Kryetarja e Gjykatës së bashku me Administratorin do të bëjnë organizimin dhe lëvizjen e stafit, me qëllim të efikasitetit dhe funksionimit.

Zbatimi i plotë i legjislacionit për respektimin e gjuhëve zyrtare edhe me rastin e mbajtjes së seancave gjyqësore, trajtimit të lëndëve si dhe adresimit të akteve gjyqësore

Gjykata Themelore në Prishtinë edhe gjatë vitit 2025 do të zotohet në respektimin e legjislacionit për respektimin e gjuhëve zyrtare, si me rastin e mbajtjes së seancave ashtu edhe me përkthimin e shkresave. Zyra e Përkthimeve në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka mungesa të theksuara të përkthyesve, andaj gjatë këtij viti planifikohet që të krijohet një trup e përkthyesve e cila do të shërbejë vetëm për Departamentin Special të GJTHP-së, duke marrë parasysh se në atë departament për shkak të lëndëve dhe rëndësisë është paraqitur nevoja më e madhe për përkthyes.

Zbatimi i akteve të KGJK-së lidhur me organizimin e brendshëm dhe menaxhimin e punës së gjykatave, performancën e gjykatave, si dhe normën e punës së gjyqtarëve.

Gjykata Themelore në Prishtinë mbetet e përkushtuar në zbatimin e plotë të Rregullores X/2024 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2025 në vazhdimësi nga Kryetari i Gjykatës do të mbikëqyret zbatimin e segmenteve kyçe të parapara në këtë Rregullore, si dhe nga Administratori i Gjykatës do të kërkohet raport në lidhje me zbatimin e kësaj rregullore nga stafi administrativ.

Kryetarja e Gjykatës duke u bazuar në nenin 22 të Rregullores për Normën e Gjyqtarëve e do ta monitoroj në baza mujore normën e gjyqtarëve. Në lidhje me realizimin e normës do të diskutoj me gjyqtarët individualisht a po në kolegjiume dhe në çdo rast do të merre masa për të ndihmuar në realizimin e normës, në ato raste kur ekziston mundësia. Në çdo rast tjetër, për të gjeturat do të njoftoj Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Plani për Drejtësi Procedurale në Gjykata

Gjatë vitit 2025 në Gjykatën Themelore në Prishtinë do të përfundoj projekti për drejtësi procedurale i financuar nga USAID, sipas planit të veprimit të punuar nga grupi punues në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Po ashtu, gjatë vitit 2025 duke marrë parasysh se është vitit i fundit i këtij projekti, në bashkëpunim me zyrtarët e projektit do të parashihen edhe disa punime që mund të përfundohen gjatë këtij viti, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarit.

Zbatimi i udhëzuesit për politikën ndëshkimore me qëllim të krijimit të praktikës së uniformitetit në shqiptimin e dënimeve brenda sistemit gjyqësor

Gjykata Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2025 do të mbetet e përkushtuar në zbatimin e udhëzuesit për politikën ndëshkimore tash së fundi të reviduar nga Gjykata Supreme. Në kolegjiumet e mbajtura do të kërkoj vazhdimisht nga gjyqtarët zbatimin e udhëzuesit dhe do të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës takime të përbashkëta me Gjykatën e Apelit, në mënyrë që të mundësohet zbatimi më i mirë i këtij udhëzuesi.

Grupi i punës për shqyrtim paraprak të lëndëve civile

Me qëllim të shqyrtimit të hershem të padive në lëmin civile, do të punoj një grup prej së paku tre zyrtareve.

Zbatimi i udhëzuesit për referimin e rasteve në procedurë të ndërmjetësimit si mjet alternativ për zgjidhjen e lëndëve

Duke vepruar sipas protokollit për referimin e rasteve në ndërmjetësim e nxjerrë nga KGJK me mbështetjen e USAID-it, Gjykata Themelore në Prishtinë në bashkëpunim me projektin përkatës do të bëjë përpjekje në rritjen e numrit të zyrtarëve që do të mbështesin zyrën e ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si dhe do të angazhoj një zyrtar dhe bashkëpunëtor në këtë zyre me qëllim të zbatimit sa më të mirë të udhëzuesit për referimin e rasteve në ndërmjetësim.

Nga gjyqtarët në çdo fazë dhe gjate trajtimit të lendeve do të kërkohet që të bëjnë përpjekje që të aplikojnë procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, në veçanti të tentohet zgjidhja e çështjeve përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjatë vitit 2025, synojmë rritjen e numrit të lëndëve të referuara në ndërmjetësim, me pajtimin e palëve dhe bazuar në legjisllacionin në fuqi.

Hartimi i planit për monitorimin e punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve dhe administratës nga Kryetari i Gjykatës

Bazuar në Aktet e KGJK-së dhe tash së fundi Rregullores X/24 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetarja e Gjykatës çdo muaj do të vazhdoj të kërkoj nga Zyrtarja për Statistika normën e punës së gjyqtarëve dhe normën e punës për bashkëpunëtor profesional, sipas formularit të miratuar nga KGJK.

Në raportet periodike 3(tre) mujore do të bashkëngjitet një pjesë e veçantë si pjesë e raportit që do të përfshijë të dhënat e mbledhura.

Hartimi i raporteve periodike për KGJK-në bazuar në rezultatet e treguara, si dhe sfidat eventuale të paraqitura gjatë punës brenda gjykatës

Kryetarja e Gjykatës para Këshillit Gjyqësor të Kosovës çdo 3(tre)muaj do të dorëzoj raportin e punës për rezultatet e treguara dhe sfidat e paraqitura në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degë.

Hartimi i raporteve lidhur me zbatimin e rekomandimeve të pranuar nga NJIGJ

Gjykata Themelore në Prishtinë ka krijuar një formë të raporteve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të pranuar nga Njësia për Inspektim Gjyqësor, i cili raport përmban:

- *Përmbledhjen e rekomandimeve*
- *Statusin e zbatimit*
- *Veprimet e ndërmarra*
- *Pengesat dhe Sfidat*
- *Propozimet për Përmirësim*

Raportet do të dërgohen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si pjesë përbërëse e raportit periodik.

Hartimi i raporteve që dalin nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore e të cilat ndërlidhen me punën e gjykatës si dhe planeve për adresim të rekomandimeve nga KGJK

Gjykata Themelore në Prishtinë ka krijuar një formë të raporteve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që dalin nga monitorimet e realizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore, e i cili raport do të përmbajë:

- *Përmbledhje e monitorimeve*
- *Të gjeturat kryesore*
- *Analiza e ndikimit*
- *Plani për adresimin e gjetjeve*

Raportet në lidhje me zbatimin e monitorimeve do të dërgohen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si pjesë përbërëse e raportit periodik.

Hartimi i raporteve për numrin e seancave të mbajtura, seancave të shtyera dhe seancave të anuluar

Gjykata Themelore në Prishtinë ka krijuar një formë të raportit në lidhje me numrin e seancave të mbajtura, të shtyera dhe të anuluar, ku raporti do të përpilohet për çdo muaj nga Zyrtarja për Statistika dhe do të përmbajë:

- *Mbledhjen e të dhënave*
- *Analizë statistike*
- *Arsyet për shtyrje/anulim*
- *Masat për zvogëlim*

Zbatimi i Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2023-2025, Planit Strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit dhe Planit Strategjik për Komunikim me Media

Kryetari i Gjykatës do të sigurojë mbikëqyrje të përditshme gjyqësore dhe menaxheriale në zbatimin e planit strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi. Qëllimi i këtij plani strategjik është paraqitja e një vizioni të përgjithshëm strategjik për adresimin dhe zgjidhjen e lëndëve të cilat janë me prioritet, përfshirë lëndët që janë kthyer në rigjykim, lëndët të cilat janë të prioritetit të lartë në bazë të ligjeve përkatëse, lëndët të vilat janë punuar në gjykata dhe ka kaluar dy vite për të cilat nuk ka filluar trajtimi i tyre, si dhe lëndët e tjera për të cilat duhet ndërmarrë veprime të përshpejtuara.

Po ashtu, sipas kërkesës së Komisionit për Monitorimin e Zbatimit të Planit Strategjik për trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit çdo 3 muaj do të nxjerrë statistika të veçanta në lidhje me trajtimin e këtyre lëndëve dhe në çdo kolegjum të mbajtur do të diskutoj të gjeturat. Gjykata Themelore në Prishtinë edhe gjatë vitit 2025 do të mbetet e përkushtuar në zbatimin e rregulloreve të nxjerra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Plotësimi i Pozitave të lira në Administratën e Gjykatës Themelore në Prishtinë për Vitin 2025

Plotësimi i pozitave të lira për gjykatën është e domosdoshme nga që ka ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe produktivitetin në punë.

Sa i përket pozitave të referentëve tani më pozitat kryesisht janë plotësuar dhe natyrisht që përgjatë vitit 2025 pritet që të vërehet impakti i tyre, duke ngritur performancën dhe efikasitetin e gjykatës por edhe llogaridhënien.


Aktualisht pozita të lira të cilat duhet të plotësohen përgjatë vitit 2025 janë:

- 1 (një) Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike;
- 2 (dy) Bashkëpunëtorë Professional;
- 12 (dymbëdhjetë) Zyrtar Ligjor;
- 1 (një) Zyrtar për Logjistikë;
- 1 (një) Referent;
- 2 (dy) Arkëtarë;
- 1 (një) Zyrtar për përkthime;
- 8 (tetë) Fletë dorëzues;
- 1 (një) Depoist;

Gjithsejtë pozita të lira janë 33, pa përfshirë pozitat e lira të rojeve të sigurimit për faktin se strategjia e SKGJK është që siguria kryesisht të mbikëqyret përmes Dhomës së Monitorimit e cila është rregulluar në Objektivin A të Pallatit të Drejtësisë.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani Rama



Synimet e Gjykatës në realizimin e objektivave që dalin nga plani i punës			
		Minimumi i caktuar nga KGJK	Synimi i caktuar nga Gjykata
I.	Reduktimi i lëndëve sipas planit strategjik për qasje në drejtësi 2022-2025	20%	30%
II	Reduktimi i lëndëve të vjetra	20%	20%
III.	Realizimi i normës së punës së gjyqtarëve	100%	100%
IV.	Realizimi i normës së punës së bashkëpunëtorëve profesional	100%	100%
V.	Ngritja e cilësisë së vendimmarrjes respektivisht zvogëlimi i numrit të lëndëve të kthyer në rigjykim	20%	50%
VI.	Rritja e numrit të vendimeve të publikuara	30%	80%
VII.	Rritja e numrit të seancave bllok në trajtimin e lëndëve	30%	50%
VIII.	Planifikimi i seancave dhe zvogëlimi i numrit të seancave të shtyra dhe të anuluar	20%	40%
IX.	Rritja e kualitetit të të dhënave në raport me regjistrimin e lëndëve e deri në përfundim të lëndëve duke harmonizuar dosjen elektronike me dosjen fizike me të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra	95%	95%
X.	Vendosja e drejtë e vendimeve gjyqësore në regjistrin e Evidencës Penale	100%	100%
XI.	Zbatimi i planit për drejtësi procedurale	100%	100%
XII.	Regjistrimi i plotë i të gjitha lëndëve në arkiv	100%	100%